

VENDIM
Nr. 85, datë 9.2.2022

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 78, DATË 31.1.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR
ZHVILLIM NË NJËSITË ADMINISTRATIVE 4 DHE 8, ZONA “5 MAJI”, BASHKIA
TIRANË, DHE ÇAKTIMIN E BASHKISË TIRANË SI NJËSI ZBATUESE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “iii” e “iv”, dhe 16, pika 3, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 78, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli i vendimit ndryshohet dhe bëhet, si më poshtë vijon:

“Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në njësitë administrative 4 dhe 8, zona “5 Maji”, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e Bashkisë Tiranë dhe shoqërisë “Tirana DC” sh.a., si njësi zbatuese”.

2. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Shpalljen si zonë e përshtatshme për zhvillimin e detyruar, të zonës “5 Maji”, njësitë administrative 4 dhe 8, Bashkia Tiranë, zonë e re për zhvillim, sipas hartës dhe koordinatave të aneksi nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

3. Në pikën 2, fjalia hyrëse ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese në pjesët e sipërfaqes, sipas hartës dhe koordinatave, dhënë në aneksin nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për: ...”.

4. Pas pikës 2, shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

“2.1 Caktimin e “Tirana DC” sh.a., si njësi zbatuese në pjesët e sipërfaqes, sipas hartës dhe koordinatave, dhënë në aneksin nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për:

- a) ndërtimin e banesave të reja ose të ndërtesave publike të dëmtuara;
- b) realizimin e ndërtimeve në këtë zonë;
- c) çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të kësaj zone.”.

5. Harta dhe koordinatat bashkëlidhur vendimit nr. 78, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohen me anekset 1, 2 dhe 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

6. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

KUFIRI I ZONËS PËR RINDËRTIM 5 MAJI | ANEKSI 3

